

**UNIVERSITETI MJEKËSOR I TIRANËS**  
**FAKULTETI I MJEKËSISË**  
**DEPARTAMENTI I LABORATOREVE**  
**PROGRAMI I DOKTORATURËS**

**DISERTACION :**

**i paraqitur nga**

**Emirvina Koliçi**

**PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE**

**“DOKTOR”**

**Rëndësia e vlerësimit të aktivitetit të 5  $\alpha$ -reduktazës ne patologjitë e lidhura me këtë enzimë.**

**UDHËHEQËS SHKENCOR: Prof. Asc Dorina Ylli**

**DISERTACION :**

**i paraqitur nga**

**Emirvina Koliçi**

**PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE:**

**“DOKTOR I SHKENCAVE MJEKËSORE”**

**Specialiteti:**

**Laborator Klinik Biokimik**

**TEMA: Rëndësia e vlerësimit të aktivitetit të 5  $\alpha$ -reduktazës në patologjitë e lidhura me këtë enzimë.**

Mbrojtur në datë .../.../... para komisionit

- |                            |                  |
|----------------------------|------------------|
| 1. Prof. Anyla Bulo        | Kryetar          |
| 2. Prof. Rubena Mojsiu     | Anëtar           |
| 3. Prof. Etleva Refatllari | Anëtar (Oponent) |
| 4. Prof. Enver Roshi       | Anëtar           |
| 5. Prof. Gjergj Theodhosi  | Anëtar (Oponent) |

## Falenderime

Mirënjohje për të gjithë profesorët, kolegët dhe bashkëpunëtorët e mi që më mbështetën dhe me inkurajuan në çdo moment të këtij rrugëtimi të gjatë. Falenderime të veçanta për udhëheqësin shkencor, Prof. Asc Dorina Ylli për ndihmën e pakufishme profesionale dhe njerëzore

## Abstrakt

### Rëndësia e vlerësimit të aktivitetit të 5 $\alpha$ -reduktazës në patologjitë e lidhura me këtë enzimë

**Hyrje:** Kaskada e hormoneve steroide përfshin aktivitetin metabolik të enzimeve të ndryshme si 5 $\alpha$ -reduktase (5 $\alpha$ R) përgjegjës për konvertimin e testosteronit (TT) në dehidrotosterone (DHT). Qëllimet e këtij studimi janë të përcaktojnë rolin e 5 $\alpha$ -Reduktazës në DSD, PCOS dhe hirsutizëm idiopatik.

**Metoda.** Gjatë periudhës 2011- 2016 u vlerësuan 170 subjekte të moshës femnore nga moshë neonatale deri në pubertet për të vëzhguar nivelin e testosteronit DHT si dhe raportin TT/DHT për të vlerësuar aktivitetin e 5 alfa reduktasës, ku 10 pacientë ishin me hemafrotizëm ,8 prej tyre në moshën neonatale , pas lindjes, dhe 2 raste në pubertet.Në studim u përfshinë 100 raste të femrave fertile, me moshe nga 16-40 vjeç të diagnostikuara me ovar polikistik, sipas kritereve të Rotterdam , të shoqëruara me ekzaminime klinike , biokimike dhe hormonale që përfshinin ekzaminime me Echo te ovareve, peshës, ekzaminime biokimike(glicemi, lipidograme) dhe ekzaminime hormonale që përfshinin TSH, FSH,LH, estradiol, prolaktine, insulin, Testosteron , DHT si dhe raporti TT/DHT për vlerësimin e aktivitetit të 5 $\alpha$  reduktazës.Në studim u përfshinë edhe 40 raste me hirsutizëm, diagnoza e të cilave u vendos sipas kritereve të sistemit Ferriman Gallwey që realizon vlerësimin me anë të pikëzimit përse i përket pilozitetit. Në studim u morën përfshinë rastet me pikezim më të madh se 10.

**Rezultati:**Në PCOS Vihet re se kemi një korelacion pozitiv perTT dhe DHT (  $p < 0.001$ )dhe përse i përket raportit është sinjifikativ( $p = 0.045$ ). Gjithashtu kemi një korelacion pozitiv per LH dhe raportit LH/FSH(perkatësisht  $p < 0.001$ )Korelacioni është pozitiv per insulinën, glicemisë dhe raportit HOMA (perkatësisht  $p < 0.001$ ,  $p < 0.008$ ,  $p < 0.001$ ) si dhe midis TT/DHT dhe insulinemise, TT/DHT dhe HOMA. ( përkatësisht  $p < 0.001$  dhe  $p < 0.020$ ). Mes pacienteve me HI dhe grupit te kontrollit vihen re se korelacion pozitiv për insulinën dhe HOMA si dhe mes TT,DHT, TT/DHT, LH/FSH, HOMA, triglicerid mes pacientëve me PCOS dhe hirsutizëm . Në rastet me deficieti të 5-alpha reduktazës kemi një korelacion pozitiv mes TT dhe TT/DHT të pacientëve hermafroditë krahasuar me fëmijët normal përkatësisht  $p < 0.002$  dhe  $p < 0.033$ .

**Konkluzioni :** Sindroma e PCOS është një sëmundje heterogjene me shumë fenotipe dhe aspekte metabolike të ndryshme. Megjithatë, hiperandrogjenizmi konsiderohet si një faktor kyç. i pranishëm në 72% në subjektet me ovar polikistik të pasuar nga obeziteti dhe oligoamenorrhea.Raporti TT/DHT ose aktiviteti i shtuar i 5- alfa reduktazës kishte lidhje sinjifikative me fenotipet A dhe D të PCOS dhe lidhet me Hirsutizmin obezitetin dhe me insulinorezistencën .Hirsutizmi idiopatik zë 29% të hirsutizmit total me prani të insulinorezistencës,me një lidhje statistkisht të rëndësishme me insulinën dhe HOMA-IR në krahasim me grupin e kontrollit,Përcaktimi i aktivitetit te 5- $\alpha$  reduktasës në moshën nga 0-3 muaj ka rëndësi për diagnozën e hershme per zbulimin në kohe të deficiencës 5- $\alpha$  reduktasës, ku rritja e raporti TT/DHT shërben si biomarker për vendosjen e diagnozes për deficietit të 5  $\alpha$  reduktazës.

# Përmbajtja

## Shkurtime

- I. Kapitulli i I
  - 1.1 Sfondi teorik
  - 1.2 Funksioni
  - 1.3 Defiçit i lindur i 5 alfa-reduktazës
  - 1.4 Hirsutismi idiopatik
  - 1.5 Sindromi i ovarit polikistik
- II. Kapitulli i II
  2. Qëllimi dhe Objektivat
    - 2.1 Qëllimi
    - 2.2 Objektivat
- III. Kapitulli i III
  3. Metoda dhe struktura e studimit
    - 3.1 Popullata në studim
    - 3.2 Kriteret e përfshirjes
    - 3.3 Kriteret e përjashtimit
    - 3.4 Mbledhja e të dhënave
    - 3.5 Metodikat
- IV. Analiza statistikore
- V. Rezultate
  - 5.1. Vlerësimi i aktivitetit të alpha -5-reduktazës në ovarin polikistik në kuadrin e një gjëndje hiperandrogjenizmi
  - 5.2. Vlerësimi i aktivitetit të alpha -5-reduktazës në Hirsutizmin idiopatik në kuadrin e një androgjenemie normale
  - 5.3. Vlerësimi i aktivitetit të alpha -5-reduktazës në gjendjet interseksuale
- VI. Përfundime
- VII. Rekomandime
- VIII. Referenca

## Shkurtime

FSH	Hormoni folikulostimulues
LH	Hormoni luteinizues
TSH	Hormoni tiroidostimulues
PRL	Prolaktina
DHEA-S	sulfati i Dehidroepiandrostedionit
TT	Testosteroni total
DHT	Dehidrotestosteroni
17 OH PRG	17 OH progesteroni
AIS	Sindromi I insensitivitetit androgjen
DSD	Çrregullime të zhvillimit seksual
PCOS	Ovari Polikistik
HI	Hirsutizem idiopatik
AMH	Hormoni anti Myllerian
HCG	Human chorionic gonadotropin
5 $\alpha$ R	5 alfa reduktazë

## 1. Kapitulli i I

### 1.1 SFONDI TEORIK

Testosteroni (T) është androgjeni më i rëndësishëm në serum. Përafërsisht 97% e T është e lidhur me SHBG (sex-hormone binding globulin) dhe 3% është i lirë dhe biologjikisht aktiv. T sintetizohet nga qelizat Leydig të testeve nën kontrollin e hipotalamusit dhe adenohipofizës. Në fetuset meshkuj, T stimulon diferencimin e kanalit Eölfian në organet gjenitale të brendshme mashkullore (epididimis, vezikulat seminale) dhe zhvillimin e shënjavave seksuale mashkullore si dhe fillimin e spermatogjenezës në pubertetit [1, 2]. Testosteroni hyn nga qarkullimi i gjakut në qelizë përmes proceseve që mbeten jo shumë të qarta. Testosteroni intraqelizor shndërrohet në dihidrotestosteron (DHT), i cili është përgjegjës për transaktivizimin e receptorit androgjen (AR), nga enzima 5 alfa-reduktaza ( $5\alpha$ -R). Pas lidhjes dhe transaktivizimit të komponentëve, kompleksi DHT-AR zhvendoset nga citoplazma në bërthamë dhe aktivizon transkriptimin e gjeneve përkatëse.

DHT është e rëndësishme për diferencimin in utero, për zhvillimin e prostatës, organeve gjenitale të jashtme mashkullore (penis dhe scrotum) dhe në pubertet për shfaqjen e pilozitetit të fytyrës dhe trupit. DHT luan gjithashtu një rol të rëndësishëm në disa sëmundje, të cilat përfshijnë aknet, hirsutizmin, hiperplazinë beninje të prostatës (BPH) si dhe kancerin e prostatës (CaP) [3]. Roli i DHT u zbulua pas përshkrimit të defiçitit të  $5\alpha$ -R2 në një grup meshkujsh nga Republika Dominikane [4]. DHT ka 2-5 herë më shumë afinitet për AR sesa T, dhe rrit deri në 10 herë më shumë inductimin e sinjalizimit AR sesa T [5], që do të thotë se efektet e tyre janë të ndryshme, por plotësuese të efektit të njëra-tjetës. [6].

Njihen tre izoenzime të  $5\alpha$ -R ( $5\alpha$ -R1-3) [7] dhe dy proteina të tjera që shfaqin aftësi 5-alfa reduktuese, glikoproteina sinaptike 2 (GPSN2), dhe glikoproteina sinaptike 2-like (GPSN2L) proteina. Vetëm njëra është identifikuar si enzimë 5 beta-reduktase ( $5\beta$ -R). Produktet e saj,  $5\beta$ -izomerë, janë përcaktuar si epi-produkt, siç është  $5\beta$ -DHT (epi-DHT) [8]. Disa komponime janë evidentuar si inhibues të sistemit të enzyms  $5\alpha$ -R dhe ato luajnë një rol të rëndësishëm në parandalimin dhe trajtimin e shumë sëmundjeve. [9].

Pavarësisht zbulimin të 5 alfa-reduktazës që në vitin 1951, si dhe rolin e saj në konvertimin e testosteronit në dihidrotestosteron, rëndësia e 5 alfa-reduktazës në patologji të ndryshme nuk është vlerësuar deri në 1974. Substrati specifik për këto enzime përfshin testosteronin, progesteronin, androstenedionin, epi-testosteronin, kortizolin, aldosteronin dhe deoxitesteronin por përveç rolit kryesor në kthimin e testosteronit në dehidrotestosteronin roli i tij nuk është shumë i njohur.


$5\alpha$ -reduktazat ndahen në 3 grupe dhe në 5 izoenzime në total. Këto grupe janë:

- a.  $5\alpha$ -R1 and  $5\alpha$ -R2,
- b.  $5\alpha$ -R3,
- c. GPSN2 and GPSN2L proteina

## Funksioni i 5 $\alpha$ -reduktazës

### 1. 5 $\alpha$ -reduktazat (5 $\alpha$ -R1-3) [29, 30]

Substrati i veprimit për 5 $\alpha$ -reduktazat janë 3-okso (3-keto),  $\Delta$ 4,5 C 19 / C21 steroidet. Grupi "3-keto" i referohet lidhjes dyfishe oksigjen-karbonit në karbon 3. Delta 4, 5 i referohet lidhjes dyfishe midis atomeve të karbonit 4 dhe 5. Veprimi përfshin një prishje stereospecifike, të pakthyeshme të lidhjes dyfishe midis karbonit 4 dhe 5 (delta 4, 5) me ndihmën e kofaktorit NADPH dhe futjen e një anioni hidrid (H<sup>-</sup>) në karbonin C-5 dhe një proton në pozicionin C-4. Shembuj të substrateve janë T, progesteroni, androstenedione, epi-T, kortizoli, aldosteroni dhe deoxycorticosterone.



### Roli klinik i 5 $\alpha$ -R (5 $\alpha$ -reduktazës)

Defektet në konvertimin e Testosteronit në DHT nga enzima 5 $\alpha$ -R shoqërohen me një numër patologjik tek njeriu.

### Defiçiti 5 $\alpha$ -R2

Çrregullimet e zhvillimit seksual (DSDs) përfshijnë një grup të gjerë patologjik që ndikojnë me gravitet të ndryshëm në nivele të organeve riprodhuese të brendshme e të jashtme. Fenotipisht zhvillimi seksual fillon sipas një rrjedhje llogjike duke nisur nga kromozomet seksuale që e përcaktojnë. Shpeshherë janë quajtur dhe gjëndjet interseksuale, hermafroditë ose pseudohermafroditë.

Diferencimi i gonadeve ndodh gjatë muajit të dytë të jetës fetale. Zhvillimi i gonadeve të padiferencuara në teste vjen si rezultat i materialit gjenetik që ndodhet në krahun e shkurtër të kromozomit Y. Nëse ky material gjenetik mungon atëherë gonadi i padiferencuar zhvillohet si ovar.

Zhvillimi i duktusit internal vjen si rezultat i efektit parakrine të gonadeve ipsilaterale. Mungesa e indit testikular do të çojë në zhvillimin e brendshëm dhe të jashtëm femëror. Kur indit testikular është present zhvillimi mashkullor do të varet nga dy hormone që janë testosteroni dhe hormoni anti Myllerian.(23)

Testosteroni i prodhuar nga qelizat Leyding ndikon në diferencimin mashkullor të ductusit të Wolff. Prodhimi i pakët i tij do të çojë në mosdiferencim mashkullor të fetusit (ocotestis) ose një prodhim i shtuar i tij çon në orientim mashkullor të një fetusit femëror(CAH)

Kështu prodhimi i androgjeneve është shumë i rëndësishëm në diferencimin seksual të fetusit si dhe në zhvillim seksual të mëvonshëm të tij.(24)

Sot përdoret gjerësisht termi DSDs për këto situata mjekësore specifike që përfshijnë:

- 46,XX hiperplazia adrenale kongenitale (CAH)
- Defekte në biosintezën e testosteronit
- Sindromi I insensitivitetit androgjen (AIS)



- Sindromi Swyer
- Deficiti i 5-alpha reductase
- 46,XY mikropenis
- Sindromi Klinefelter syndrome
- Sindromi Turner (45,X)
- Hypospadija
- Epispadija
- Sindromi Mayer-Rokitansky-Kuster-Hauser s
- 46,XX/46,XY (, ovotesticular DSD)
- Persistenca e duktusit Müllerian
- Sindromi Kallman
- Deficiti i 17-beta reductase (XX or XY)
- 46,XY deficiti i 3-beta-hydroxysteroid dehydrogenase deficiency (HSD deficiency)
- Aphallia
- Clitoromegaly
- 46,XY cloacal exstrophy
- Progesteron-induced virilizim


Situatat me te shpeshta jane hiperplazia adrenal kongjenitale (CAH), sindromi i insensitivitetit androgjen(AIS) si dhe deficieti i 5-alfa reduktase .

Deficiti i 5-alpha reductasës është një sëmundje autozomale recesive që karakterizohet nga mungesa e konvertimit të testosteronit total në dehidrotestosteron. Meqënëse DHT është përgjegjës për zhvillimin e organeve të jashtme genitale fëmijët me deficiet i 5 alpha reduktasës lindin me ambiguitet genital.

Deficiti i 5 $\alpha$ -R2 shkakton uljen e sintezës së DHT për shkak të mutacioneve në gjenin SRD5A2, përgjegjës për prodhimin e 5 $\alpha$ -R2 .Janë identifikuar të paktën 50 mutacione dhe në shumicën e rasteve është një patologji autosomale-recesive .

Karakteristikat biokimike të këtij sindromi përfshijnë si më poshtë.

- nivele normale ose të rritura të T,
- nivele normale ose të ulëta të DHT,
- rritje të raportit të T /DHT në fillim dhe pas stimulimit të hCG,
- metabolizëm normal të T dhe DHT,
- nivele të ulëta të metabolitëve steroide C19 e C21 të 5-të reduktuar në urinës të me rritje të raportit të metabolitëve 5 $\beta$  / 5 $\alpha$ inar,
- ulje të nivelit të 3 $\alpha$ -androstane diol në plazmës dhe urinë, një metabolit kryesor i DHT,
- rritje të niveleve plazmatike të LH dhe / ose FSH.
- Fenotipi, zhvillimi dhe funksioni riprodhues te femrat me mungesë 5 $\alpha$ -R2 janë të pa prekura..




***Skemë e veprimit të testosteronit dhe dehidrotestosteronit në nivel qelizor.***

Metabolizmi i steroideve është në formën e një kaskade ku produkti përfundimtar është dehidrotestosteroni.

Organet gjinore të jashtme të të dyja seksve përcaktohen rreth javës së 7 të jetës intrauterine. Prania ose jo e androgjeneve do të orientojë fetusin në shprehjen fenotipike mashkullore ose femërore.

Gonadet mashkullore prodhojnë nivele të rritura të testosteronit që konvertohet nëpërmjet 5 alfa-reduktazës në dehidrotestosteron (DHT). Kjo enzime ndodhet në citoplazmën e qelizave të sinusit urogenital. DHT kapet nga receptoret intraqelizore dhe transportohet në bërthamë ku bëhet transmetimi i informacionit gjenetik.

Kur do të kemi një mungëse të transformimit të TT në DHT atëherë do të kemi një zhvillim jo të plotë të maskularizimit të fetusit.



### *Skemë e efektit biokimik të deficiencës së 5 alfa-reduktaza në sintezën e testosteronit*

Konvertimi i testosteronit në DHT është esencial për formimin e fenotipit mashkullor gjatë embriogenezës. Defiçiti lindur i 5- $\alpha$  reduktase është një sëmundje autozomale reçensive që karakterizohet nga vlera normale të testosteronit total dhe nga vlera të ulëta të DHT (raporti T/DHT është i rritur). Ky defiçit shoqërohet me moszhvillim të organeve seksuale mashkullore tek fetusit mashkull i prekur, me një incidencë 1:20000 fetuse meshkuj. Këta paciente mund të kenë organe genitale mashkullore, ambiguos genitalia ose organe genitale femerore. (26,27)

Pra vlerësimi i aktivitetit të kësaj enzime është shumë i rëndësishëm për përcaktimin e shkaktarit të patologjive të ndryshme. Ky vlerësim mund të bëhet në menyrë indirekte duke parë raportin testosteron total/dehidrotestosteron. Studimet e ndryshme kanë treguar gjithashtu se raporti mes androsteron /epiandrosteron sulfat shërben si një tjetër metode e thjeshtë indirekte për vlerësimin e aktivitetit 5- $\alpha$  reduktasës. (28,29)

Për vleresimit aktivitetit 5- $\alpha$  reduktase realizohet një test stimulimi me HCG( human chorionic gonadotropin) gjatë të cilit maten vlerat e testosteronit, dhe dehidrotestosteronit para dhe pas injektimit me HCG.

Vlerat normale te raportit TT/DHT jane 8-16:1 ndërsa në deficiet të 5 alfa-reduktazës ato shkojnë më të rritura se 35:1(24,29)

Prandaj diagnozën e deficietit të 5 alfa-reduktazës , në fëmijë të dyshuar për deficiet të kësaj enzime,e vleresojmë nëpërmjet testit të stimulimit me HCG vlerësuar pikerisht raportin TT/DHT. HCG është një hormon polipeptid dyfishtë dhe ka një nën-njësi të përbashkët me LH. Ajo stimulon qelizat Leydig të prodhojnë testosteron nëpërmjet receptorëve të LH. HCG ka një gjysëmjetë të gjatë (2.5 ditë) dhe prodhon një rritje progresive por modeste të testosteronit për 72-120 orë.

### ➤ Procedura

Realizimi I ketij stimulimi nënkupton injektimin e HCG dhe matjen e vlerave të testosteronit, androstenedionit dhe dehidrotestosteronit.

- Dita 0: marrim gjakun për testosteron, androstenedione dhe dihidrotestosterone
- Administrojmë 1500 njësi (neonat) ose 5000 njësi (mbi 2 vjet) HCG subkutane ose im
- Dita 4: marrim gjak për matjen e testostosterone, androstenedione dhe dehidrotestosterone

### ➤ Rezultati

Pas vlerësimit të vlerave të testosteronit, androstenedionit dhe dihidrotestosteronit shikohet kjo përgjigje në grupmosha te ndryshme.

	testosterone	DHT	T/DHT pas hCG
Meshkuj normal adult	8-27 nmol/L	< 2.9 nmol/L	<12
Femije normal (6 muaj - pubertet)	< 0.9 nmol/L	< 0.1 nmol/L	<12
5 $\alpha$ -reductase (6 muaj - pubertet)	< 0.5 nmol/L		>12

Nga kjo tabelë arrihet në konkluzinin se:

- Ka një rritje 2-9 herë të testosteronit në djemtë normale prepubertal.
- meshkujt normale do te kemi:
  - . Në javën e parë ka një koncentrim ngritur moderuar testostosterone për shkak të stimulimit gonadal nga hCG e nënës..vlerat e testosteronit fillojne te ulen
  - Pastaj vlerat e testosteronit ulen gradualisht deri në pubertet

- ndërsa në deficitit të 5 alfa-reduktazës ato shkojnë në vlera normale të testosteronit dhe vlera të ulëta deri të padedektueshme të DHT

#### 1.4 Hirsutismi

Hirsutizmi ,hiperpiloziteti mashkullor që zhvillohet tek femrat, është një nga çrregullimet më të shpeshta endokrine që prek rreth 10% të femrave si rezultat i çrregullimit të aktivitetit të andogjeneve.

Ai zhvillohet si rezultat hiperandrogjenemisë që mund të vijë si rezultat:

- i sekretimit të shtuar të androgjenëve(shoqërohet me vlera të rritura të tyre )e shkaktuar me shpesh nga sindroma e ovarit polikistik si patologjia me e shpeshte endokrine e femrave në moshën riprodhuese.
- rritjes së ndjeshmërisë periferike ndaj androgjenëve.

##### 1.4.1 Sindromi e ovarit polikistik

Sindromi e ovarit polikistik është ndër patologjitë më të shpeshta endokrine në femrat fertile . Stein dhe Leventhal fillimisht e përshkruanin atë në vitin 1935.


PCOS është çrregullim endokrin që karakterizohet nga një çrregullim i sistemit riprodhues dhe atij 13metabolic që përfshijnë hiperandrogjenizmin, disfunksioni ovarial dhe nga ndryshime morfologjike në ovare (prania e kisteve) si dhe simptoma të tjera klinike e biokimike si hirsutizmi , hiperinsulinemia (insulinorezistence ) hiperprolaktinemia, etj . Është vlerësuar se kjo patologji prek 4-12 % të femrave në moshën fertile.

Kjo patologji karakterizohet me mungesë e maturimit të folikujve dhe hiperplazi të stromës që shoqërohet me hipersekretim të androgjenëve. Ky prodhim vlerësohet me anë të dozimit të LH që rezulton i lartë.)

Faktorët që mund të çojnë në zhvillimin e PCOS janë të paqartë por studime të ndryshme nxjerrin si shkaktarë të ndryshëm megjithatë mendimi i përgjithshëm është se PCOS është product i një sërë faktorësh si :

- Faktorët gjenetikë, PCOS besohet të jetë një çrregullim kompleks, me faktorë gjenetikë si dhe mjedisorë që kontribuojnë në zhvillimin e sëmundjes.(35). 20-40% e pacienteve me PCOS kanë familjarë me të njëjtën diagnozë, duke sygjëruar transmetimin gjenetik të saj. (35).Këta faktorë mund të ndahen në intrauterine dhe ekstrauterinë.(36)

- Faktorët intrauterine
  - Peshë e ulët në lindje/SGA
  - Ekspozim fetal ndaj androgjeneve HAK, SOP amtar
  
- Faktorët Extrauterine dhe Mjedisi
  - Shtim i shpejte i peshes pas lindjes
  - Adrenarke prekokse \*2x rritje risku
  - Moshe e hereshme e zhvillimit pubertal
  - Obeziteti: si shkak me i shpeshte i insulinorezistences
  - Streset, aktivitet fizik me i pakët (36)
  
- Ekspozimi ndaj testosteronit gjatë jetës intrauterine mund të ndikojë në shfaqjen e PCOS në pubertetet .(35).
  
- Stili I jetës është një tjetër faktor rrisht për PCOS. Jeta sedentare shoqërohet me rritje të rrezikut për sindrom metabolik dhe shtimi në peshë shoqërohet me oligo/anovulim dhe hiperandrogjenizmin. .(35).
  
- Obeziteti besohet se nuk shkakton PCOS por përkeqëson simptomat e saj. Obeziteti është i pranishëm në 30-75% të rasteve me PCOS. Dëmtimi i adipociteve kontribuon në zhvillimin e intolerancës së glukozës dhe hiperinsulinemisë, e cila nga ana tjetër mund të përshkallëzojë manifestimet e hiperandrogjenizmit. Gratë obeze me PCOS janë më të prirura për anovulim dhe infertilitet.(35).



*Hiam 2019*

Fispatologjia e PCOS dhe pasqyrimi klinik i ndryshimeve metabolike të tij. (Hiam 2019)

Fispatologjia e PCOS ka të bëjë me ;

- Hiperandrogjenizmi është tipari më kryesor i PCOS, madje mund të quhet dhe tipari përcaktues i saj. Hiperandrogjenizmi përkeqësohet nga hiperinsulinemia. Karakteristika të ngjashme të ovareve janë vërejtur të gratë me hiperandrogjenizëm siç është hiperplazia kongjenitale e surenale.
- Çrregullimet neuroendokrine. Gratë me PCOS kanë një rritje të shpeshtësisë të sekretimit të GnRH; I cili çon në rritje e prodhimit të hormonit luteinizues (LH) dhe ulje në prodhimin e hormonit folikulostimulues (FSH). Prandaj pacientet shfaqin një rritje të raportit LH/ FSH, e cila çon në rritje e androgjeneve ovariale në krahasim me estrogenet. Nuk është e qartë nëse pacientët me PCOS kanë një mekanizëm të sekretimit të shpeshtë të GnRH i cili shkakton hiperandrogjenizmin në ovare apo nëse oligo/anovulimi vetë rrit sekretimin e GnRH përmes një ulje të progesteronit qarkullues. Normalisht, progesteroni prodhohet nga korpus luteum pas ovulacionit dhe vepron për të ngadalësuar pulsimin e GnRH. Në PCOS, një çrregullim i ovulacionit mund të shkaktojë një ulje të progesteronit qarkullues, si dhe ekspozimi ndaj


androgjeneve në ovare mund të ulë efektet frenuese të estrogenit dhe progesteronit në hipotalamus dhe të kontribuojë në rritje të prodhimit të GnRH.

- Insulinorezistenca. 50-70% e pacientëve me PCOS shfaqin anomalitë metabolike, përfshirë tolerance të glukozës dhe hiperinsulineminë. Rezistenca insulinike konsiderohet si pasojë e defekteve në transportin e glukozës dhe sinjalizimin në adipocitet dhe miocitet; kjo mund të jetë rezultat i një çrregullimi në prodhimin e adipokinës por mekanizmi nuk është shumë i qartë. Hiperinsulinemia vepron përmes receptorëve të IGF-1.
- Ovari polikistik. Ovaret polikistike janë të pranishme në 20-30% të grave me PCOS. Kistet janë shumë folikula antrale që nuk janë zhvilluar plotësisht. Kjo mendohet të ndodhë për shkak të anomalive hormonale:
  - Hiperandrogjenizmi: rritja e androgjeneve çon në uljen e prodhimit të estradiolit të rëndësishëm për maturimin e folikulit.
  - Hiperinsulinemia: përkeqëson hiperandrogjenizmin në ovare duke - rritur aktivitetin e 17 $\alpha$ -hidroksilazës duke rritur prodhimin e androstenedionit dhe e testosteronit; - rritje e prodhimit të androgjenëve nga stimulimi i LH- dhe IGF1; dhe - rritje e free testosteronit duke ulur prodhimin e globulinës lidhëse të hormonit seksual (SHBG).(35)



# Pathophysiology of PCOS


Alex Rotstein, Ragini Srinivasan, and Eric Wong



Fiziopatologija e PCOS (35)

# Polycystic Ovarian Syndrome (PCOS): Pathogenesis and clinical findings

**Authors:** Lauren Standerwick  
**Reviewers:** Mackenzie Grisdale, Amy Fowler, Christina Schweitzer, Bernard Corenblum\*  
 \* MD at time of publication



PCOS mund të shoqërohet me patologji të shumta duke përfshirë infertilitetin, sindromën metabolike, obezitetin, intolerancë të glukozës, diabeti mellitus tip 2 (DM-2), rrezikun për sëmundje kardiovaskulare, depresionin, kancerin endometrik .(30)

Kjo patologji mund të shfaqet në formën e sindromës Stein-Leventhal (OPK tip I) ose në formën e distrofisë makrofolikulare (OPK tip II)

- **Sindromës Stein-Leventhal (OPK tip I)** klinikisht shoqërohet me oligomenorre primare, mbipeshë, ovaret janë të mëdhenj me mikrofolikula e të padhimbshëm.

Në kuadrin hormonal vëmë re anomali të sekretimit të gonadotropinave , hipersekretim i LH dhe insuficiencë e FSH që karakterizohet nga një raport  $LH/FSH > 2$ . Testosteroni dhe androstenedioni janë në vlera të rritura. Në ekografi të ovareve mikrokiste.

- **OPK tip II** karakterizohet nga oligomenorreja sekondare. Ovaret janë të mëdhenj , të dhimbshëm, me madhësi të ndryshme nga njeri cikël në tjetrin.

Në kuadrin hormonal vëmë re rritje të androgjenëve dhe çrregullimet e LH,FSH më pak të ndjeshme se në rastin e OPK tip I.

Shkaqet më të shpeshta janë mbipeshja, hipertiroidizmi, hiperprolaktinemia, insulinorezistenca ose shkaqe jatrogjene.

#### ➤ **Diagnoza e PCOS**

Në tre dekadat e fundit janë bërë tre përpjekje për të standardizuar diagnozën e sindromës e ovarit policistik (PCOS). Fillimisht, një nën grup kriteresh u sugjerua në National Institutes of Health (NIH) (Zawadzki and Dunaif, 1992) në të cilën dy kriteret kryesore si hiperandrogjenizmi klinik/biokimik dhe anovulimi kronik ishin të nevojshme për diagnozën. Më pas , në një seminar të organizuar nga European Society of Human Reproduction and Embryology and the American Society for Reproductive Medicine, u propozua që të paktën dy nga tre kriteret e mëposhtme ishin të detyrueshme: oligo-anovulimi, hiperandrogjenizmi klinik/biokimik dhe prania ekografike e ovarit polikistik.(PCO) (kriteret e Rotterdam)2004. Së fundmi, Androgen Excess and PCOS (AE-PCOS) Society (Azziz et al., 2006) rekomandoi që hiperandrogjenizmi klinik ose biokimik duhet të jetë thelbësor për diagnozën, por gjithashtu kërkohej disfunksioni i ovular në formën e oligo-anovulimit ose PCO.

Edhe duke përdorur të njëjtin nëngrup të kriterëve diagnostikuese, studimet epidemiologjike paraqesin variacione të rëndësishëm në prevalencën e fenotipeve të ndryshme brenda grupeve të popullatave në studim.

Gjithashtu ndikim në fenotipet e PCOS mund të jenë dhe efektet e racës dhe përkatësisë etnike, veçanërisht, në paraqitjen klinike të hiperandrogjenizmit (Chen et al., 2008) dhe pranisë së folikulave në ultrasonografi (Dewailly et al., 2011)

	1990 NIH	2003 ESHRE/ASRM (Rotterdam)	2006 AE-PCOS Society	2012 NIH Consensus <sup>4</sup>
Criteria	2 of 2 criteria required: 1. HA 2. OA	2 of 3 criteria required: 1. HA 2. OA 3. PCOM*	2 of 2 criteria required: 1. HA 2. Ovarian dysfunction (OA, PCOM, or both*)	Recommended use of the 2003 Rotterdam criteria, but with the specification that the specific phenotypes included be identified: • Phenotype A: HA+OA+PCOM* • Phenotype B: HA+OA • Phenotype C: HA+PCOM* • Phenotype D: OA+PCOM*
Exclusions			Exclusion of similar or mimicking disorders	

Ndryshimi I kritereve të diagnozës së PCOS ndër vite. ( HA –hiperandrogjenizem, OA-oligoamenorrhe, PCOM ndryshim morfologjik në Echo të ovarit) Azziz 2018.

Diagnoza e PCOS do të varet dhe nga moment i diagnostikimit. Diagnoza e PCOS mund të bëhet në adoleshencë ose me vone në moshë adulte

Në adoleshencë do të merren për bazë këto kritere.

- ▶ Cikle menstruale te crregullta te perkufizuara ne baze te viteve post menarke;
  - > 90 dite per cdo cikel pas menarkes (> 1 vit pas menarke),
  - cikle < 21 apo > 45 dite (> 1 deri < 3 vite post menarke);
  - cikle < 21 apo > 35 dite (> 3 vite post menarke)
  - amenorrhea primare deri ne moshen 15 ose > 3 vite post telarke

\*Ciklet menstruale te crregullta (< 1 vit post menarke) i parashikuar ne tranzicionin normal pubertal.

Hiperandrogjenizem i perkufizuar si hirsutizëm, akne të rënda dhe ose hiperandrogjenemi biokimike.

- ▶ Ekografia pelvike nuk eshte e rekomanduar per diagnozen e SOP deri ne 8 vite post menarke.

Diagnoza e ovarit polikistik në adult vendoset në bazë të kritereve të Rotterdam që përfshin këto karakteristika:

- 1) oligo- ose anovulacion,
- 2) Shënja klinike dhe/ose biokimike të hiperandrogjenizmit
- 3) Ovar polikistik (më shumë se 12 kiste)

PCOS është një gjendje hiperandrogjenike me oligo-anovulim që nuk mund të shpjegohet me ndonjë çrregullim tjetër. Prandaj diagnoza e PCOS është një diagnozë përjashtuese. Patologji të cilat duhet përjashtuar në vendosjen e diagnozës së PCOS janë:

- Hiperplazia kongenitale adrenale
- Deficit i 21 hidroxilazes (në serum rriten vlerat e 17 oh progesteronit)
- Sindroma Cushing
- Tumore që sekretojnë androgjene (të rrallë)
- Hiperprolaktinemia

Klinika e PCOS përfshin :

- çrregullime menstruale: PCOS kryesisht shoqërohet me oligomenorrhea (më pak se nëntë cikle menstruale në vit) ose amenorrea (pa cikle menstruale për tre ose më shumë muaj rresht). (31)
- Steriliteti: Kjo në përgjithësi rezulton drejtpërdrejt nga anovulimi kronik (31)
- Nivele të larta të hormoneve mashkullore: Të njohura si hiperandrogjenizëm, shenjat më të zakonshme janë aknet dhe hirsutizmi por mund të shoqërohet dhe me hipermenorre alopeci androgjenike (31)
- Sindroma metabolike: Kjo shfaqet si një prirje drejt obezitetit dhe simptomave të tjera që lidhen me insulinorezistencën. (31)


Në vlerësimet laboratorike në serum do të kemi :

- Testosteroni (TT)
- DHT (Dehidrotestosteroni)
- FSH (Hormoni folikulostimulues)
- LH (Hormoni luteinizues)
- LH/FSH >2
- Estradioli
- Prolaktina
- TSH (Hormoni tiroidostimulues)
- Insuline
- DHEA-S (sulfati i Dehidroepiandrostenedionit)
- 17 OH Progesteron

### Në diagnozën ekografike kemi praninë e këtyre parametrave:

Në PCOS shohim praninë e shumë strukturave të vogla kistike, që quhen folikuj antral, që i japin pamjen karakteristike ovarit në formë polikistike. Në ECHO duhet të kemi :

- Të paktën 1 ovar më të madh se  $10\text{ cm}^3$  in volume ose
- Të paktën 1 ovar të ketë 12 ose më shumë folikuj antral të evidentuar në ECHO.



### Diagnoza e PCOS duke vlerësuar nivelet e FSH dhe LH

Shumica e femrave me PCOS (por jo të gjitha) kanë një raport LH/FSH jo normal.

Për të prodhuar në mënyrë normale folikujt dhe ovocitet, FSH e LH duhet të kenë vlera të caktuara të tyre në moment të ndryshme të ciklit menstrual.

- Normalisht raporti është 1 : 1 , do të thotë se nivelet e FSH, LH janë të ngjashme
- FSH e LH janë në përgjithësi në vlerat 4-6 në femrat fertile
- Në PCOS raporti LH/FSH është shpesh 2:1 ose 3:1
- Në PCOS vlerat e FSH janë rreth 4- 8 ndërsa vlerat e LH janë 10-20
- Mund të ndodhë që një femër me PCOS mund të ketë vlera normale të FSH, LH e raportit LH/FSH por diagnostikohet me PCOS nga kritere të tjera (më lartë)
- Për këtë arsye vlerësimi vetëm i FSH e LH nuk është gjithmonë i rëndësishëm në diagnozën e PCOS

Në një femër me PCOS kemi nivelet e larta të FSH e LH të cilat stimulojnë prodhimin e androgjeneve nga ovaret. Kjo shoqërohet me prodhim të shtuar të testosteronit total i cili nëpërmjet 5 alfa reduktazës konvertohet në dehidrotestosteron (DHT) përgjegjës për ndryshimet morfologjike dhe funksionale të ovareve dhe si çrregullimet metabolike të organizmit. Aktiviteti i 5 alfa reduktazës luan një rol kyç në formimin e DHT i cili ka një afinitet me të lartë për receptorët androgjenike në periferi dhe është përgjegjës për shenja klinike seksuale sekondare androgjenike si hirsutizmi, ndryshimet morfologjike dhe funksionale të ovareve si dhe çrregullimet metabolike. Prandaj nivelet serike të Testosteronit total (TT) ,DHT, si dhe vlerësimi i aktivitetit të 5 alfa reduktazës nëpërmjet raportit TT/DHT konsiderohen si tregues diagnostikues për aktivitetin androgjenik përgjegjës për çrregullimet biokimike , klinike në PCOS.

Vlerësimi i gjendjes hiperandrogjenike nëpërmjet vlerësimit të nivelit të hormoneve androgjenike si dhe rritja e aktivitetit të 5 alfa reduktazës që shoqëron inbalancën hormonale me rritje të efektit të DHT në periferi akuzohet si shkaktarë në patogjenezën e PCOS dhe hirsutizmit .

Sipas kriterëve të Rotterdam 2003 PCOS ndahet në 4 fenotipe. (Tabela me poshtë)

Fenotipi I	Fenotipi II	Fenotipi III	Fenotipi IV
Oligo anovulacion PCOM	Rritje e androgjeneve PCOM	Rritje të androgjeneve Oligo anovulacion	Rritje të androgjeneve Oligo anovulacion PCOM

PCOM-(polycystic ovary morphology)\*

Karakteristikat klinike të PCOS, si insulinorezistenca , obeziteti, dislipidemia dhe hiperandrogjenizmi, mund të klasifikohen si sindroma metabolike. Prandaj, 43% e femrave adulte dhe gati një e treta e adoleshente me PCOS kanë sindromë metabolike .

#### 1.4.1.1 Insulinorezistenca në PCOS

Insulinorezistenca (IR) është e zakonshme në pacientët me PCOS. IR është raportuar në afërsisht 50-80% të grave me fenotipe të ndryshme të PCOS në raca të ndryshme [46,47,48]. Ky hiperinsulinizmi kompensues mund të shkaktohet në pacientë me PCOS për shkak të ndjeshmërisë së ulët ndaj insulinës në indet periferike, të muskujve të skeletit dhe indit dhjamor si dhe anomalitë e receptorëve të insulinës [49]. Mekanizmi kryesor i anomalisë së receptorit të insulinës që çon në IR është defekti në lidhje për shkak të fosforilimit të tepërt të serinës dhe uljes së fosforilimit të tirozinës, të cilat ulin aktivizimin e insulinës të rrugës sinjalizuese të fosfatidilinositol-3-kinazës

(PI3k) që aktivizon transportin e glukozës[50]. Vitet e fundit, ka studime të reja rreth IR në PCOS. Për shembull, prania e ndryshimeve të mikroRNA në PCOS është konfirmuar nga shumë studime, por mekanizmi është i panjohur. Dong et al. kanë treguar se një nga mikroRNA: miR-122 mund të çojë në IR duke frenuar shprehjen e IGF-1, duke dhënë një ide të re mbi mekanizmin e IR në PCOS [51]. Përveç kësaj, Zhang et al. kohët e fundit zbuloi se ekziston një lidhje midis IR dhe autofagjisë.

#### **1.4.1.2 Obeziteti në PCOS**

Obeziteti, veçanërisht obeziteti abdominal, është një manifestim i zakonshëm i PCOS, dhe prevalenca varet nga vendndodhja gjeografike dhe përkatësia etnike [56]. Studimet kanë treguar se obeziteti abdominal mund të shoqërohet me një sërë karakteristikash klinike të PCOS. Për shembull, për shkak të mosfunksionimit të indit dhjamor, adipocitet sekretojnë nivele jo-fiziologjike të adipokineve, duke përfshirë IL6, IL8, TNF- $\alpha$ , leptinën, adiponektinën, rezistinën, lipokalinën 2, MCP1, proteinën lidhëse të retinolit-4. (RBP4), dhe ligandi 5 CXC-kemokine (CXCL5), i cili mund të përfshihet në IR [57,58,59,60]. Përveç kësaj, një studim i kohëve të fundit ka treguar se obeziteti mund të funksionojë si një parashikues më i mirë i masës muskulore skeletore tek gratë me PCOS sesa hiperandrogjenizmi dhe IR, të cilat mund të përkeqësojnë komplikimet e PCOS [61]. Mosfunksionimi i indit dhjamor mund të ndikojë në zhvillimin e folikulave. Një studim i fundit tregoi se IL-10 i sekretuar nga adipocitet pengon angiogjenezën e induktuar nga VEGF dhe dëmton më tej folikulogjenezën [62].

#### **1.4.1.3 Hiperandrogjenizmi në PCOS**

Një nga kriteret e diagnostikimit të PCOS është hiperandrogjenizmi. IR, obeziteti dhe hiperandrogjenizmi janë të bashkëshoqërues në patogjenezën e PCOS. Hiperinsulinemia e shkaktuar nga IR ushtron një efekt të gonadotropinës në ovare dhe ul nivelet e proteinës lidhëse të hormoneve seksuale (SHBG), duke çuar në shfaqjen e hiperandrogjenizmit [65,66]. Androgjenet mund të nxisin akumulimin e indit adipoz , veçanërisht në regjionin abdominal, dhe të shkaktojnë IR në indin adipoz subcutan [67,68]. Tek njerëzit, androgjeni luan një rol të dyfishtë në folikulogjenezën: nivelet e ulura të androgjeneve nxisin rritjen e folikulave, ndërsa një nivel i lartë i androgjenëve mund të rrisë sekretimin e hormonit anti-Müllerian (AMH) në qelizat granuloze , duke penguar kështu zhvillimin e folikulave [69]. Disa studime kanë raportuar gjithashtu mekanizma të tjerë të mundshëm të PCOS të induktuar nga hiperandrogjenizmi, si dehidrotosteroni (DHT), i cili mund të kontribuojë në ndarjen mitokondriale në qelizat granuloze të pacientëve me PCOS . [70,71 ]. Përveç kësaj hiperandrogjenizmi mund të kontribuojë në inflamacionin kronik të shkallës së ulët në ovocite[72]. Prandaj, hiperandrogjenizmi luan një rol të ndërlikuar në PCOS.



#### 1.4.1.4 Dislipidemia në PCOS

Dislipidemia konsiderohet si një fenotip i rëndësishëm metabolic në PCOS , megjithëse nuk është një kriter diagnostikues. Është raportuar se prevalenca e dislipidemisë në pacientët me PCOS është 70%, dhe nivelet e LDL-Kolesterolit (loë-density lipoprotein cholesterol), VLDL-kolesterolit (very-loë-density lipoprotein cholesterol), triglicerideve (Tgs) dhe acidi yndyror të lira janë të rritura, ndërsa nivelet e HDL-kolesterolit (high-density lipoprotein cholesterol) janë ulur [73,74]. Pacientët jo obezë kanë një prevalencë më të lartë të hipertrigliceridemisë dhe HDL të ulët [75]. Dislipidemia ndikon në një rrezik më të lartë për patologji cerebrovaskulare dhe kardiovaskulare. [77].

#### 1.5.Hirsutismi idiopatik

Hirsutismi prek rreth 5% dhe 10% të femrave (72,73). Në shumicën e rasteve hirsutizmi vjen si pasojë e patologjive të tjera si p.sh., PCOS, tumoret sekretuese të androgjenëve, hiperplazia adrenale jo klasike (NCAH), ose insulinorezistenca .Përjashtim mund të jenë ata pacientë me “hirsutizëm idiopatik” (IH). Shpeshherë hirsutismi idiopatik konsiderohet “familjar” por ky është një koncept i gabuar.

##### 1.5.1 Zhvillimi normal i qimes së flokut

Ka afërsisht 50 milionë folikula të flokëve që mbulojnë trupin e njeriut , nga të cilët 100,000 deri në 150,000 janë në lëkurën e kokës, folikulat e mbetura janë në faqet në fytyrë . Të vetmet zona pa folikulat e qimeve janë shputat e këmbëve, pëllëmbët e duarve dhe buzët. Ka shumë pak flokë të rinj folikulat e formuara pas lindjes, dhe numri i folikulave të flokëve fillon të ulet pas moshës 40 vjeçare (8, 9).

Faza më e hershme e jetës embrionale të njeriut në të cilën bëhet organizimi i epidermës që çon në formimin e strukturës së flokëve është midis 9 dhe 12 javë (10, 11).

Flokët përbëhen nga proteinat e keratinës, të cilat formojnë flokët boshtin e tij. Boshti i flokëve rritet brenda mbështjellësit të jashtëm të rrënjës së flokëve, e cila është pjesë e epidermës. Strukturisht, ka tre lloje flokësh. *Lanugo* është flokë i butë që mbulon lëkurën e fetusit, e cila humbet midis muajit të parë dhe të muajit të katërt pas lindjes. Flokët *vellus* janë gjithashtu të butë dhe të imët, por më të mëdha se qimet lanugo. Flokët velus janë zakonisht pa pigment, në përgjithësi me përmasa më pak se 2 mm të gjatë dhe mbulojnë zonat e trupit në dukje pa qime. Histologjikisht, qimet e velusit kanë diametra që nuk i kalojnë 0,03 mm.(12). Qimet terminale janë më të gjata, të pigmentuara. Këto qime formojnë vetullat, qerpikët, lëkurën e kokës flokët, dhe qimet pubike dhe të aksilave në të dy gjinitë, si dhe qimet e trupit dhe të fytyrës së meshkujve (8, 9). Qimet terminale janë përshkruar shpesh si i "meduluare" .Në lëkurë, gjëndrat e flokëve formojnë grupe, të quajtura njësi folikulare (FU); çdo FU përbëhet nga afërsisht dy deri në katër qime ,folikulat së bashku me gjëndrat dhjamore dhe indin lidhor . (13–15). Përqendrimi i FU-ve në lëkurë, të paktën në skalp, mund të ndryshojë ndërmjet grupeve etnike (13, 14). Megjithatë, nuk

ka dallim gjinor në numrin e FU-ve brenda çdo grup racor/etnik. Prandaj, ndryshimi i dukshëm në rritjen e qimeve të trupit midis burrave dhe grave nuk ka lidhje me numrin e FU-ve, por për llojin dhe cilësinë e flokëve brenda këtyre folikulave (8, 9)

### **1.5.2 Fazat e rritjes dhe mekanizmat e rregullimit i rritjes së qimes së flokut**

Ka tre faza të rritjes së flokëve. Një rritje aktive ose faza (anagen); e ndjekur nga një fazë involucionare (katagen), në të cilën flokët ndalojnë së rrituri dhe folikuli i flokëve tkurret; dhe së fundi, faza telogjene në të cilën flokët gradualisht eliminohen, pasi do të zëvendësohen nga qimet e reja. (8, 9). Tek njerëzit, flokët janë në rritje të vazhdueshme që vjen si rezultat i disinkronisë në fazat e rritjes midis folikulave të flokëve të ndryshëm. Në thelb, ndërsa disa qime janë në fazën aktive të rritjes (anagen), të tjerët janë në fazën telogjene, dhe anasjelltas, duke dhënë përshtypjen e rritjes së vazhdueshme. Kohëzgjatja e fazës së rritjes do të ndryshojë në varësi të vendin ku ndodhet gjëndra e flokëve. Për shembull, në lëkurën e kokës faza anagen mund të zgjasë 2 deri në 6 vjet, ndërsa faza anagen për qimet e trupit mund të zgjasin vetëm 3 deri në 6 muaj. Ndërsa kohëzgjatja e fazave të katagenit dhe telogjenit është e ngjashme në lëkurën e kokës dhe qimet e trupit dhe zgjasin 2 deri në 3 javë dhe 3 deri në 4 muaj, përkatësisht. Raporti anagjen-telogjen (raporti i qimeve në fazën anagjen ndaj numrit të qimeve në fazën telogjene) përdoret shpesh për të vlerësuar aktivitetin e rritjes së flokëve në zona të veçanta të lëkurës.

Steroidet seksuale dhe një sërë faktorësh lokalë dhe sistemikë mund të veprojnë direkt dhe indirekt në papilën e lëkurës për të rregulluar rritjen e flokëve. Përveç kësaj, këta faktorë mund të veprojnë edhe në faktorë të tjerë pjesë të gjëndrës së flokëve, duke përfshirë rrënjën e jashtme dhe mbështjelljet si e brendëshme dhe qelizat burimore folikulare (16), e cila mund të jetë po aq e rëndësishme sa papila epidermale në rregullimin e rritjes së flokëve.

### **1.5.3 Faktorët lokalë dhe sistemikë.**

Faktorë të ndryshëm të rritjes dhe tokina- cy janë vërejtur se ndikojnë në rritjen e flokëve (16-22). Hormonet e tjera si ato të tiroides (24, 25) dhe GH (26) mund gjithashtu ndikojnë në rritjen e flokëve. Në përgjithësi, mungesa e hormoneve të tilla, qoftë i lidhur me sëmundjen ose i shkaktuar nga medikamente, shoqërohet me ndryshime në raportin e fazave të telogjenit dhe anagjenit në lëkurën e kokës dhe qimet e trupit (24, 25, 27). Pacientët me hipotiroidizën të mjekuar me hormone tiroidiene në përgjithësi shfaqin rritje të qimeve të kokës brenda për afërsisht 8 javësh (24). Studimet kanë treguar praninë e receptorëve të hormoneve tiroidjane në pjesën e jashtme të folikulit të flokëve, dhe një efekt pozitiv i l-T3 në shumimin qelizor në folikulat e flokëve. (28). Burrat me mungesë të GH të trajtuar me zëvendësim të GH tregojnë një rritje e qimeve të trupit që ndodh pa një rritje të dukshme të androgjenëve të lirë (26), duke sugjeruar që GH mund të stimulojnë drejtpërdrejt rritjen e qimeve të trupit, pavarësisht nga një ulje e androgjenëve në qarkullim. Megjithatë nuk është vërejtur një efekt i drejtpërdrejtë i GH në rritjen in vitro të folikulave të flokëve ose në morfologjinë e tyre. Është e mundur që efekti e GH mund të ndërmyjetësohet nëpërmjet rritjes së prodhimit të IGF-I.

#### 1.5.4 Hormonet steroide

Nga hormone steroide seksuale, androgjenet janë më të rëndësishëm në përcaktimin e llojit dhe shpërndarjes së qimeve mbi trupin e njeriut. Nën ndikimin e androgjenëve, flokët folikulat që prodhojnë qime të tipit velus mund të stimulohen për të filluar prodhimin e qimeve terminale. Eksperimentet in vivo dokumentojnë më së miri efektin e androgjenëve në diferencimin e folikulave të flokëve në zonat e ndjeshme ndaj androgjenit (p.sh., organet gjenitale dhe zona e mjekrës në fytyrë) në meshkujt normal (31), eunukë (32) dhe transeksualë nga femra në meshkuj(33). Përveç stimulimit të fijeve terminale në disa zona të lëkurës, androgjenet zgjasin fazën anagjene të qimeve të trupit, duke shkurtuar fazën anagjene të qimet e kokës (34, 35). Androgjenet gjithashtu rrisin sekretimin e sebumit. Prandaj, jo vetëm që androgjenët ndryshojnë llojin e flokëve por ato mund të zgjasin qimet e trupit duke rritur gjatësinë e fazës anagjene, dhe do të rrisë nivelin e yndyrës në lëkurë dhe flokë.


Ekziston një ndryshueshmëri e konsiderueshme midis qimeve të trupit (individualisht dhe midis të ndryshmeve zonat e lëkurës) në përmbajtjen e tyre të 5 $\alpha$ -RA dhe aftësisë për të metabolizuar androgjenet.

Gjithashtu, përqendrimi i receptorëve të androgjenëve ka rëndësi në disa patologji, kryesisht IH(hirsutismi idipatik).

Progesteroni dhe estradioli, të paktën në doza të larta, gjithashtu pengojnë aktivitetin e 5 $\alpha$ -RA në organet gjenitale të njeriut dhe lëkurën pubike (71), mundësisht duke ulur prodhimin lokal të dihidrotestosteronit (DHT). Pak dihet në lidhje me efektet e drejtpërdrejta të progesteronit dhe estrogenet në rritjen e flokëve.

#### 1.5.5 Aktiviteti i 5 $\alpha$ -RA në lëkurë

.Eksperimente të shumta kanë dokumentuar konvertimin e testosteronit (T), androstenedione, dhe dehidroepiandrosteronit në DHT in vitro në lëkura dhe ndikimin e tyre në folikujt e flokut (38). DHT formohet nga konvertimi periferik i T në meshkuj dhe nga konvertimi i androstenedionit tek femrat. Prandaj efekti i androgjeneve në zhvillimin e pilozitetit ndikohet nga veprimin e 5 $\alpha$ -RA.



*Rregullimi i veprimtarisë së 5α-RA dhe prodhimi i DHT në flokë. Aktiviteti periferik 5α-RA katalizon shndërrimin e T ose androstenedione (A4) në DHT. Në flokë DHT stimulon 1) rritjen e prodhimit të sebumit; 2) diferencimin e gjëndrës së flokëve nga velat në qimet terminale; dhe 3) zgjatja e fazës së anagjenit që rezulton në qime më të trasha.*

Aktiviteti i 5α-RA përcakton prodhimin e DHT dhe, rrjedhimisht, efektin e androgjeneve në folikujt e flokëve. Progesteroni dhe estradioli në doza të larta pengojnë aktivitetin 5α-RA në lëkurën gjenitale dhe pubike ndërsa androgjenet rritin aktivitetin periferik 5α-RA .

Përcaktimi i hirsutizmit idiopatik HI mund të realizohet vetëm në femra me hirsutizëm por me funksion normal të ovareve dhe nivel normal të androgjenëve në serum. Duke u nisur nga ky kriter përjashtues HI zë më pak se 20 % të femrave me hirsutizëm.

### **1.5.6 Fizpatologjia e HI**

Ka pak informacion në dispozicion në lidhje me patogjenezën e IH. Kjo mangësi është për shkak të mungesës së teknikave molekulare për të testuar hipotezat e propozuara, të ndërlikuara nga fakti që shumica e studimeve të mëparshme kanë përfshirë pacientë në të cilët diagnoza e IH nuk ishte vendosur rreptësisht. Disa nga hipotezat mbizotëruese në lidhje me etiologjinë e kësaj çrregullimi paraqiten më poshte.

#### **1.5.6.1 Rritja e aktivitetit të 5 $\alpha$ reduktazës**

Hipoteza kryesore shtë ajo që lidhet me rritjen e aktivitetit të 5 $\alpha$ -RA në lëkurërritje e aktivitetit të lëkurës 5 $\alpha$ -RA. Jenkins dhe Ash (90)

Aktiviteti i lëkurës 5 $\alpha$ -RA mund të jetë shkak i fispatologjisë së HI, por gjithashtu është e mundur që rritja e aktivitetit në lëkurë e 5 $\alpha$ -RA mund të mos jetë një faktor i vetëm për IH. Prandaj, është e mundur që rritja e aktivitetit periferik 5 $\alpha$ -RA në IH thjesht pasqyron zhvillimin e hirsutizmit, pa marrë parasysh më pak shkakun. Në përgjithësi, nga të dhënat e disponueshme nuk është e mundur për të përcaktuar përfundimisht se rritja e aktivitetit 5 $\alpha$ -RA luan një rol parësor në zhvillimin e IH. Po kështu, është ende e paqartë se cili nga izoenzimët 5 $\alpha$ -RA, nëse ka, është mbizotërues në zhvillimin e IH. Duke përdorur analiza molekulare e mRNA-ve specifike për izoenzimët, përqendrimet e izoenzimës 5 $\alpha$ -RA të tipit 1 në gjëndrat dhjamore ishte më e lartë te pacientët me akne (94, 95), në dallim me përqendrimin e izoenzimës së tipit 2. Në përputhje me këtë gjetje, përdorimi i finasteride (një frenues i tipit 2 5 $\alpha$ -RA) nuk pati efekt në prodhimi i sebumit tek meshkujt që trajtohen për hiperplazinë e prostatës (96). Megjithatë, ndryshe nga aknet, ka të ngjarë që Izoenzima e tipit 2 luan një rol të rëndësishëm në hirsutizëm meqenëse finasteridi është të paktën pjesërisht efektiv në trajtimin e tij. (78,79).

#### **1.5.6.2 Polimorfizmi e receptorive të androgjenëve**


Edhe pse është supozuar se ka një ndryshim në numrin e receptorëve periferikë të androgjenëve në IH, (në numër.) ndërmjet pacientëve me IH dhe grupeve të kontrolleve nuk janë gjetur ndryshime në kapacitetin lidhës për androgjenit (d.m.th.përmbajtja e receptorit androgjen (81). Megjithatë, është e mundur që të kemi dallime, më shumë cilësore, se sa sasiore, tek gratë me IH. Një ndryshim i tillë funksional mund të rezultojë nga ndryshime gjenetike të receptorit androgjen

dhe mund të jetë e mjaftueshme për të shpjeguar zhvillimin e hirsutizmit në mungesë të ndryshimeve në nivelet e androgjenit qarkullues(79). Në fakt, variacionet gjenetike të receptorit të androgjeneve janë shoqëruar me zhvillimin e çrregullimeve të tjera të lidhura me androgjenin, si kanceri i prostatës (80). Për më tepër, dihet se variacionet e sekuencës ndodhin më shpesh në gjenin e receptorit androgjen sesa në gjenet e receptorët e tjerë steroidë( 81), dhe është e mundur që këto polimorfizma të ndikojnë në ndjeshmërinë ndaj androgjenit dhe shprehjen fenotipike.

Një shembull i një variacioni gjenetik të zakonshëm, që mund të ndikojë në funksionin e receptorit të androgjenit, është numri të trinukleotideve CAG që përsëriten në ekzonin 1 të gjenit të receptorit androgjen. Këto përsëritje trinukleotide janë gjetur me diferenca të shumta (d.m.th., të jenë polimorfikë) midis njerëzve (82). Kodonet CAG janë përgjegjëse për një shtrirje të gjatë glutaminash brenda vargut të amino terminalit në domenit e transaktivizimit të receptorëve të androgjenëve. Zgjerimi i këtij rajoni të receptorit të androgjenit kohët e fundit është përfshirë në zhvillimin e çrregullimeve të lëkurës të lidhura me androgjenin si tek meshkujt ashtu edhe tek femrat, duke përfshirë alopecinë androgjenetike dhe hirsutizmin (79, 80)

Këto studime sugjerojnë se zhvillimi i hirsutizmit,dhe ndoshta IH, mund të ndikohet në një farë mase nga karakteristikat molekulare të receptorit androgjen.


Përcaktimi I shkallës së gravitetit të hirsutizmit është realizuar nga Ferriman dhe Gallwey që përcaktuan një shkallë pikëzimi që vlerëson nga 1-4 (ku 4 është vlera maksimale) 9 pjesë të ndryshme të trupit. Pra pikëzimi maksimal është 36.(skema e mëposhtme) Në bazë të këtij pikëzimi do të kemi prani të hirsutizmin nëse vlerësimi është >8.



Skema e pikëzimit Ferriman Gallwey

Në kuadrin e vlerësimit biokimik –hormonal pacientët me hirsutizëm idiopatik karkterizohen nga nivele normale të testosteronit dhe të androgjenëve.

Këto femra shpesh janë obese, kanë intolerancë të glukozes si dhe/ose insulinorezistencë dhe shumë shpesh shfaqin shënjat e sindromit metabolik.



### 1.5.7. Vlerësimi hormonal në HI .

- Vlerësimi hormonal në HI do të përfshijë:
  - Matjen e nivelit të DHT. Duke qënë se shkakut i IH është rritja e aktivitetit të 5- $\alpha$  reduktase në rastet me IH do të kemi rritje të nivelit të DHT. Megjithatë shpeshhere mund të kapin nivele normale të DHT meqënëse pjesa më e madhe e DHT prodhohet në lëkurë dhe nuk sekretohet në gjak.
  - Vlerësimi i aktivitetit të 5- $\alpha$  reduktase do të realizohet nga raporti i TT/DHT . Për këtë arsye do të maten dhe nivelet serike të testosteronit total për të kryer raostin mes tyre.
  - Në studim do të përfshihen dhe parametra të tjere bashkeshoqërues si FSH, LH, estradiol, progesterone ,insulin, parametra biokimike si glicemi, lipidogramë dhe përlllogaritjen e HOMA.
- Gjithashtu do të realizohet dhe përcaktimi klinik i Hirsutismit idiopatik duke vlerësuar shënjat klinike , përcaktimin e nivelit të hirsutism sipas pikëzimit Ferriman Gallëey



## Kapitulli II

### 2. Qëllimi dhe objektivat e studimit

#### 2.1 Qëllimi i studimit

Rëndësia e vlerësimit të 5  $\alpha$ -reduktazës në vendosjen e hershme të diagnozës dhe në ndjekjen më të mirë të trajtimit në patologjitë e cituara më poshtë.

#### 2.2 Objektivat:

##### Objektivat e këtij studimi janë:

.

1. Vlerësimi i aktivitetit të 5  $\alpha$ -reduktazës në ovarin polikistik në kuadrin e një gjendje hiperandrogjenizmi
2. Vlerësimi i aktivitetit të 5  $\alpha$ -reduktazës në hirsutizmin idiopatik në kuadrin e një androgjenemie normale
3. Vlerësimi i aktivitetit të 5  $\alpha$ -reduktazës në gjendjet interseksuale
4. Përcaktimi i incidencës të sëmundjeve në grupmosha të ndryshme.

#### 2.3 Metodologjia

**Tipi i studimit:** Ky ishte një studim prospektiv,

### **2.3.1 Popullata e marrë në studim**

Gjatë periudhës 2011-- 2016 u rekrutuan 170 subjekte të moshës feminare nga mosha neonatale deri në pubertet për të vëzhguar nivelin e testosteronit dehidrotestosteronit si dhe raportin TT/DHT për të vlerësuar aktivitetin e 5 alfa reduktasës.

Në këtë grup u futën dhe 10 pacientët më hemafrotizën ,8 prej tyre në moshën neonatal , pas lindjes, dhe 2 raste në pubertet. 4 prej rasteve të moshës neonatal ishin nga e njëjta familje, të njëjtët prindër, ku 3 raste përfunduan në vdekje të fëmijës.

Në 8 rastet e moshës neonatal diagnoza u vendos në momentin e lindjes e shoqëruar dhe me vlerësinin e kariotipit.

Në studim u përfshinë 100 raste të femrave fertile, me moshe nga 16-40 vjec të diagnostikuara me ovar polikistik, sipas kriterëve të Rotterdam , të shoqëruara me ekzaminime klinike , biokimike dhe hormonale që përfshinin ekzaminime me Echo te ovareve, peshës, ekzaminime biokimike(glicemi, lipidograme) dhe ekzaminime hormonale që përfshinin TSH, FSH,LH, estradiol, prolaktine, insulin, Testosteron , dehidrotestosteron, si dhe raporti TT/DHT për vlerësimin e aktivitetit të 5 $\alpha$  reduktazës.

Në studim u përfshinë 40 raste me hirsutizëm, diagnoza e të cilave u vendos sipas kriterëve të sistemit Ferriman Gallëey që realizon vlerësimin me anë të pikëzimit përse I përket pilozitetit. Në studim u morën përfshinë rastet me pikezim më të madh se 10. Në këtë grup u përjashtuan femrat me çrregullime ovariale(të menseve dhe kiste ovariale) Në të gjitha keto raste u bë vlerësimi klinik dhe hormonal I pacienteve që përfshin matjen e niveleve të FSH,LH, estradiol, kortizol bazal ora 8.00, Testosteron total dhe Free Testosteron, Dehidrotestosteron si dhe raporti TT/DHT për vlerësimin e aktivitetit të 5 $\alpha$  reduktazë.

Në studim u përfshinë dhe 30 raste kontrolli të femrave në moshë fertile ,klinikisht dhe metabolikisht normale

### **2.3.2. Analiza statistikore**

Të dhënat u perpunuan duke përdorur programin SPSS. Të dhënat e vazhdueshme u vlerësuan për shpërndarje normale duke përdorur testin Shapiro-Wilk. Të gjitha të dhënat e vazhdueshme me shpërndarje normale u krahasuan me testin e T-test ose ANOVA. Të dhënat me shpërndarje jo normale u krahasuan duke përdorur testin e Mann Whitney ose Kruskal–Wallis. Variablat kategorike u krahasuan me testin Chi-square ose Fischer. Vlera P- <0.05 u konsiderua statistikisht e rëndësishme.



### 2.3.3. Metodika

#### 2.3.3.1. Matja e hormoneve ne serum me metoden me chemiluminescence

Hormonet FSH, LH, estradiol, progesterone, testosterone total, androstenedion, TSH, insulin janë matur me aparaturën Immulite 100.

Baza e këtij aparati qëndron në Test unit , i cili përmban një sferë të veshur me antitrupe përkatës, dhe nëpërmjet ultracentrifugimit bën largimin e likidit në dhomën e dhomëzën e testit duke bërë një ndarje të saktë për analizat me ndjeshmëri të lartë.

Metoda me chemiluminescence të ndërlidhur me enzimë e përdorur në IMMULITE 1000 rrit saktësinë dhe ndjeshmërinë e matjes për hormonet me përqëndrime të ulëta në gjak.



Metoda e ultracentrifugimit në Immulite 100

Ndjeshmeria e lartë e e matjes në Immulite 100

### Matja e estradiolit

#### Principi i metodës

Matja e estradiolit me Immulite 1000 është metodë chemiluminescence enzimmatike në fazë të ngurtë ,me metodën me kompeticion.

#### Principi i reaksionit.

Faza e ngurtë është e lidhur me antitrupe monoclonal anti-estradiol. Reagenti përmban fosfatazë alkaline të konjuguar tek estradioli. Estradioli i konjuguar me enzimën konkuron me estradiolin e pacientit për tu ildhur me antitrupe në fazën e ngurtë. Teprica e reagentëve dhe mostrës së serumit largohen nëpërmjet larjes centrifugale. Në fund shtohet substrati chemiluminescent dhe sinjali i gjeneruar është proporcional me enzimën e lidhur.

Cikli I inkubimit zgjat 1 x 60 min.

### **Materiali biologjik**

Për matjen e estradiolit përdoret serum, I përftuar nga marrja e gjakut me tuba me xhel. Përdorimi I tubave të tjerë me antikoagulantë si litium heparinë dhe K3EDTA nuk janë të këshillueshëm për matjen e estradiolit.

Estradioli është e qëndrueshëm në serum për 2 ditë në temperaturën 2-8 gradë, dhe 2 muaj në temperaturë - 20 gradë C.

Volumi i nevojshëm është 25 µl( mostra e serumit duhet të përmbajë të paktën 100 µl më shumë nga sasia e nevojshme)

Diluimi është i rekomandueshëm për vlera më të larta se 1200 pg/ml , për të patur matje më të sakta në pjesë më të ndjeshme të kurbës.

### **Reagentët përkatës ;**

Test unit që përmban antitropa monoclonal anti-estradiol.

Reagenti përmban fosfatazë alkaline të konjuguar antitropa monoclonal anti estradiol . Duhet ruajtur në temperaturë 2-8 gradë c deri në 30 ditë.

### **Qëndrueshmëria e reagentëve**

Testet duhen ruajtur në 2 -8 gradë C.Para përdorimit duhet të arrijnë temperaturën e ambientit para përdorimit.

### **Kalibrimi i aparatit**

Kalibrimi I aparatit për kitin e estradiolit është cdo 2 javë.

### **Kontrolli i Kualitetit.**

Realizohet me të paktën 2 pika kontrolli me vlera të lartë dhe të ulët (high e loë control)

### **Llogaritja**

Autoanalizatori Immulite 100 llogarit në mënyrë automatike përqëndrimin e estradiolit për çdo analizë;

### **Lineariteti**

Për këtë kit lineariteti i kurbës është 20- 2000 pg/ml ( për vlera më të larta këshillohet diluimi)

Faktori i konvertimit : pg/ml x 3.671 → pmol /l

### **Vlerat normale**

#### **Femra :**

Faza folukulare: 0- 84 pg/ml

Piku ovulator: 34- 400 pg/ml

Faza luteale: 27-246 pg/ml

Menopauzë : 0-30 pg/ml

**Meshkuj :** 0.1-56 pg/ml

## **Matja e FSH (FOLIKULO STIMULUES HORMON)**

### **Principi i metodes**

Matja e FSH me Immulite 1000 është metodë chemiluminescence Imunometrike në fazë të ngurtë .

Test unit që përmban antitropa monoclonal anti-FSH.

Reagenti përmban fosfatazë alkaline të konjuguar antitropa monoklonal FSH. duhen ruajtur në temperaturë 2-8 gradë c deri në 30 ditë.

Cikli I inkubimit zgjat 1 x 30 min.

### **Materiali biologjik**

Për matjen e FSH përdoret serum , nuk është konfirmuar matja e FSH me mostër tjetër biologjike. FSH është i qëndrueshëm në serum për 7 ditë në temperaturën 2-8 gradë, dhe 2 muaj në temperaturë - 20 gradë C.

Volumi i kërkuar është 50 µl( mostra e serumit duhet të përmbajë të paktën 100 µl më shumë nga sasia e nevojshme)

Diluimi është i rekomandueshëm për vlera më të larta se 170 mIU/.

### **Qëndrueshmëria e reagentëve**

Testet duhen ruajtur në 2 -8 gradë C, brenda datës së skadencës.Para përdorimit duhet të arrijnë temperaturën e ambientit .

### **Kalibrimi i aparatit**

Kalibrimi I aparatit për kitin e FSH është cdo 2 javë. Adjustatorët vijnë në të njëjtin set me kitin.

### **Kontrolli i Kualitetit.**

Realizohet me të paktën 2 pika kontrolli me vlera të lartë dhe të ulët (high e loë control)

### **Llogaritja**

Autoanalizatori Immulite 100 llogarit në mënyrë automatike përqëndrimin e FSH për cdo analize.

### **Lineariteti**

Për këtë kit lineariteti i kurbës është 0-170 mIU/ml ( për vlera më të larta këshillohet diluimi)

### **Vlerat normale**

#### **Femra :**

Faza folukulare: 2.8 -11.3 mIU/ml

Piku ovulator: 5.8-21 mIU/ml

Faza luteale: 1.2- 9 mIU/ml

Menopauzë : 21.7- 153 mIU/ml

**Meshkuj** : 0.7- 11.1 mIU/ml

**Femijë** ; 0.11 – 1.6 mIU/ml

## **Matja e LH (LUTEINIZUES HORMON)**

### **Principi i metodes**

Matja e LH me Immulite 1000 është metodë chemiluminescence Imunometrike në fazë të ngurtë .

### **Reagentët përkatës ;**

Test unit që përmban antitropa monoclonal anti-LH. Pas hapjes duhen ruajtur në temperaturë 2-8 gradë c deri në 30 ditë. Para përdorimit duhet të arrijnë temperaturën e ambientit para përdorimit.

Reagenti përmban fosfatazë alkaline të konjuguar antitropa poliklonal LH. Duhen ruajtur në temperaturë 2-8 gradë c deri në 30 ditë.

Cikli I inkubimit zgjat 1 x 30 min.

### **Materiali biologjik**

Për matjen e LH përdoret serum , nuk është konfirmuar matja e LH me mostër tjetër biologjike. LH është e qëndrueshëm në serum për 14 ditë në temperaturën 2-8 gradë, dhe 2 muaj në temperaturë - 20 gradë C.

Volumi i kërkuar është 50 µl( mostra e serumit duhet të përmbajë të paktën 100 µl më shumë nga sasia e nevojshme)

Diluimi është i rekomandueshëm për vlera më të larta se 170 mIU/ml , për të patur matje më të sakta në pjesë më të ndjeshme të kurbës.

### **Qëndrueshmëria e reagentëve**

Testet duhen ruajtur në 2 -8 gradë C, brenda datës së skadencës..Para përdorimit duhet të arrijnë temperaturën e ambientit .

### **Kalibrimi i aparatit**

Kalibrimi I aparatit për kitin e estradiolit është cdo 2 javë. Adjustatorët vijnë në të njëjtin set me kitin.

### **Kontrolli i Kualitetit.**

Realizohet me të paktën 2 pika kontrolli me vlera të lartë dhe të ulët (hight e loë control)

### **Llogaritja**

Autoanalizatori Immulite 100 llogarit në mënyrë automatike përqëndrimin e LH për cdo analize;

### **Lineariteti**

Për këtë kit lineariteti i kurbës është 0-200 mIU/ml ( për vlera më të larta këshillohet diluimi)

## Vlerat normale

### Femra :

Faza folukulare:	1.1 -11.6	mlU/ml
Piku ovulator:	17- 77	mlU/ml
Faza luteale:	0- 14.7	mlU/ml
Menopauzë :	11.3- 39.8	mlU/ml

**Meshkuj :** 0.8- 7.6 mlU/ml

**Femijë ;** 0 - 3.6 mlU/ml

## Matja e testosteronit total

### Principi i metodes

Matja e testosteronit me Immulite 1000 është metodë chemiluminescence enzimatike në fazë të ngurtë ,metodë kompetitive.

### Reagentët përkatës ;

Test unit që përmban antitrupa poliklonal anti-testosteron. Pas hapjes duhen ruajtur në temperaturë 2-8 gradë c deri në 30 ditë. Duhet të arrijnë temperaturën e ambjentit para përdorimit.

Reagenti përmban fosfatazë alkaline të konjuguar antitrupa poliklonal testosteron. Duhet ruajtur në temperaturë 2-8 gradë c deri në 30 ditë.

Cikli I inkubimit zgjat 1 x 60 min.

### Materiali biologjik

Për matjen e testosteron përdoret serum , nuk është konfirmuar matja e tij me mostër tjetër biologjike. Testosteron është i qëndrueshëm në serum për 14 ditë në temperaturën 2-8 gradë, dhe 2 muaj në temperaturë - 20 gradë C. Volumi i kërkuar është 20 µl( mostra e serumit duhet të përmbajë të paktën 100 µl më shumë nga sasia e nevojshme)

### Qëndrueshmëria e reagentëve

Testet duhen ruajtur në 2 -8 gradë C, brenda datës së skadencës.

### Kalibrimi i aparatit

Kalibrimi I aparatit për kitin e estradiolit është cdo 2 javë. Adjustatorët vijnë në të njëjtin set me kitin.

### Kontrolli i Kualitetit.

Realizohet me të paktën 2 pika kontrolli me vlera të lartë dhe të ulët (high e loë control)

### Llogaritja

Autoanalizatori Immulite 100 llogarit në mënyrë automatike përqëndrimin e testosteronit për çdo analizë;

### **Lineariteti**

Për këtë kit lineariteti i kurbës është 20-1600 ng/dl ( për vlera më të larta këshillohet diluimi)

#### **Vlerat normale**

**Femra : 0- 73 ng/dl**

Menopauzë : mlU/ml

**Meshkuj :** 0.8- 7.6 mlU/ml

**Femijë ;** 0 - 3.6 mlU/ml

### **Matja e PROGESTERONIT**

#### **Principi i metodes**

Matja e progesteronit me Immulite 1000 është metodë chemiluminescence kompetitive.

#### **Reagentët përkatës ;**

Test unit që përmban antitropapoliklonal anti-progesteron.

Reagenti përmban fosfatazë alkaline të konjuguar me antitropa poliklonal anti-progesteron. Duhet ruajtur në temperaturë 2-8 gradë c deri në 30 ditë.

Cikli I inkubimit zgjat 2 x 30 min.

#### **Materiali biologjik**

Për matjen e progesteron përdoret serum , Progesteroni është i qëndrueshëm në serum për 7 ditë në temperaturën 2-8 gradë, dhe 3muaj në temperaturë - 20 gradë C.

Volumi i kërkuar është 50 µl( mostra e serumit duhet të përmbajë të paktën 100 µl më shumë nga sasia e nevojshme)

Diluimi është i rekomandueshëm për vlera më të larta se 170 mIU/ml , për të patur matje më të sakta në pjesë më të ndjeshme të kurbës.

#### **Qëndrueshmëria e reagentëve**

Testet duhen ruajtur në 2 -8 gradë C, brenda datës së skadencës.Para përdorimit duhet të arrijnë temperaturën e ambjentit .

#### **Kalibrimi i aparatit**

Kalibrimi I aparatit për kitin e progesteronit është cdo 2 javë. Adjustatorët vijnë në të njëjtin set me kitin.

#### **Kontrolli i Kualitetit.**

Realizohet me të paktën 2 pika kontrolli me vlera të lartë dhe të ulët (hight e loë control)



## Llogaritja

Autoanalizatori Immulite 100 llogarit në mënyrë automatike përqëndrimin e progesteronit për çdo analizë;

## Lineariteti

Për këtë kit lineariteti i kurbës është 0-170 ng/ml ( për vlera më të larta këshillohet diluimi)

### Vlerat normale

#### Femra :

Faza folukulare: 0- 1.13 ng/ml

Piku ovulator: 0.48 -1.72 ng/ml

Faza luteale: 0.95- 21 ng/ml

Menopauzë : 0-1.0 ng/ml

#### Shtatzanë :

Tremujori i parë: 9.2-33.2 ng/ml

Tremujorii dytë: 29- 50 ng/ml

Tremujori i tretë: 83 -160 ng/ml

## Matja e DHT (dehidrotestosteronit)

Matja e testosteronit u bë me metodën ELISA.

Reagentët ;

- Kyveta të veshura me antitrupa anti DHT (paketim 96 cope 12 x 8 të cilat përmbajnë antitrupa poliklonal anti DHT ) . Ruhen në 2-8 gradë C .
- Dihydrotestosterone-Horseradish Peroxidase (HRP) Conjugate Concentrate . Flakon 200 µl . Ruhen në 2-8 gradë C. Përgatitja : Diluimi në raport 1; 100 me buffer (p.sh 20 µl HRP me 2 ml buffer)
- Kalibratorët e DHT. Kiti shoqërohet me 6 kalibratorë me përqëndrime të ndryshme. Ruhen në 2-8 gradë C .Stabiliteti është deri në 12 muaj. Pas hapjes duhen përdorur Brenda 2 javësh ose të ruhen në – 20 gradë C .

Kalibratori	Përqëndrimi	Sasia
Kalibratori A	0 pg/ml	2.0 ml
Kalibratori B	25 pg/ml	0.6 ml
Kalibratori C	100 pg/ml	0.6 ml
Kalibratori D	500 pg/ml	0.6 ml
Kalibratori E	1000 pg/ml	0.6 ml

Kalibrator F	2500 pg/ml	0.6 ml
--------------	------------	--------

- Kontrolllet. Janë gati për tu përdorur. Stabiliteti është deri në 12 muaj. Pas hapjes duhen përdorur Brenda 2 javësh ose të ruhen në – 20 gradë C .
- **Ëash buffer.** Flakon 50 ML. Përgatitja : Diluimi në raport 1; 10 me ujë të distiluar (p.sh për gjithë sasinë 50 ml përdoret 450 ml ujë të distiluar )
- Assay buffer. 15 ml . Ruhet në 2-8 gradë C.
- TMB substrate.16 ml . Ruhet në 2-8 gradë C.
- Stopping solution. 6 ml. . Ruhet në 2-8 gradë C.

Procedura e punës.

Para përdorimit reagentët duhet të jenë në temperaturën e ambjentit.

Prepare working solutions of the DHT-HRP conjugate and ëash buffer.

1. Përgatitet DHT-HRP –CONJUGATE me ëash buffer
2. Përgatiten kyvetat për nr e rasteve si dhe kalibratorët dhe kontrolllet.
3. Pipetojme 50 µl nga çdo kalibrator , kontroll, analizë nëpër kyveta.
4. Pipetojme 100 µl nga conjugate në çdo kyvete.
5. E homogjenizojmë lehtë për 10 sekonda, pastaj e inkubojmë për 1 orë në temperaturë ambjenti.
6. E shplajmë 3 herë me 300 µl ëash buffer të përgatitur, duke e mbështetur cdo herë mbi letër thithëse.
7. Pipetojme 150 µl TMB substrat në çdo kyvete.
8. E homogjenizojmë lehtë për 10 sekonda, pastaj e inkubojmë për 10-15 minuta në temperaturë ambjenti.(ose deri sa kalibratorët të bëhen blu e errët)
9. Pipetojme 50 µl Stopping solution në çdo kyvete.
10. Lexojmë kyvetat në 450 nm Brenda 20 min nga pipetimi I Stopping Solution.

### Vlerat normale

#### Femra :

Para menopauzës: 24- 368 pg/ml

Menopauzë : 10- 181 pg/ml

**Meshkuj ;** 250- 990 pg/ml

## Matja e kolesterolit total në serum.

Metoda e matjes është ajo kolorimetrike, enzimatiqe. Si mostër biologjike vlen serum, ose plazëm me EDTA ose e heparinizuar.

### Principi matjes

Reagentët të kolesterolit përdorin metodën enzimatiqe –kolorimetrike për matjen e përqëndrimit të kolesterolit në serum/ose plazëm. Në këtë metodë esteret e kolesterolit të pranishme në materialin biologjik nën veprimin katalitik të enzimës kolesterol esterazë (CHE) hidrolizohen në kolesterol të lirë dhe acide yndyrore. Më pas kolesterol i lirë nën veprimin katalitik të enzimës kolesterol oksidazë oksidohet në kolesten dhe peroksidin e hidrogjenit ( $H_2O_2$ ). Peroksidi i hidrogjenit në prezencë të enzimës peroksidazë (POD), vepron me 4 amino antipirinën, duke na dhënë një substancë të koloruar ngjyrë roze, intensiteti i së cilës është në përpjestim të drejtë me sasinë e kolesterolit të lirë të pranishëm në serum.

### Principi Reaksionit

#### CHE

Esteret e kolesterolit +  $H_2O$  → Kolesterol + Acide yndyrore

#### CHO

Kolesterol +  $O_2$  → Cholestene +  $H_2O_2$

#### POD

$2H_2O_2 + 4$ Aminoantipirinë → substancë me ngjyrë +  $4 H_2O$

### Përbërja e reagentëve të punës.

Është monoreagent i gatshëm për tu përdorur, përbërja e të cilit është si më poshtë.

Bufer fosfat( ph 6.5)	103 mmol/l
4 aminoantipirinë	0.33 mmol
Fenol	5.2 mmol/l
Kolesterol esterazë	>0.2 kU/l
Kolesterol oksidazë	> 0.2 kU/l
Peroksidazë	> 10 kU/l

### Qëndrueshmëria e reagentëve

Reagentët e pahapur janë të qëndrueshëm në temperaturën 2-8 gradë celcius deri në datën e skadimit që e ka në etiketën shoqëruese ;kur hapen janë të qëndrueshëm po në këtë temperaturë por për 30 ditë.

### Materiali biologjik.

Serum ose plazëm e heparinizuar ose me EDTA.Rekomandohet që brënda dy orëve pas centrifugimit të ndahet serumi nga elementët e tjere të gjakut. Kolesterolin është i qëndrueshëm në serum për 5-7 ditë në temperaturën 2-8 gradë.

### **Lineariteti**

Për këtë kit lineariteti i kurbës është deri në 20-700mg/dl(0.5-18.0 mmol/l)

### **Normat**

0-200 mg/dl (<5.2 mmol/l) vlerë normale

200-239 (5.2-6.2 mmol/l) risk i mesëm

>240 mg/dl (>6.2 mmol/l) risk i lartë

### **Matja e trigliceridit në serum.**

Metoda e matjes është ajo kolorimetrike, enzimatike. Si mostër biologjike vlen serum, ose plazëm me EDTA ose e heparinizuar

### **Principi matjes**

Principi i matjes së trigliceridit në serum/plazëm, i nënshtrohet një serie reaksionesh enzimatike. Fillimisht nën veprimin katalitik të enzimës Lipazë hidrolizohet në glicerol dhe acide yndyrore. Gliceroli fosforilohet nga adenozinë tre fosfati në prani të enzimës glicerol kinazë (GK) në glicerol-3-fosfat. Glicerol -3 fosfati nën veprimin katalitik të enzimës glicerol fosfat oksidazë (GPO) oksidohet duke dhënë peroksid hidrogjeni (H<sub>2</sub>O<sub>2</sub>) dhe dihidroksiaceton-fosfat. Më tej H<sub>2</sub>O<sub>2</sub> bashkëvepron me klorfenolet dhe aminoantipirinën e reagentit të punës dhe nën katalizim të enzimës peroksidazë (POD), për të na dhënë një komponim me ngjyrë të kuqe, intensiteti i së cilës është në përpjestim të drejtë me përqëndrimin e Tg në materialin biologjik. Ky intensitet matet në gjatësi vale 500nm.

### **Principi Reaksionit**

#### **Lipazë**

Triglicerid + 3H<sub>2</sub>O → Glicerol+ Acide yndyrore

#### **GK, Mg<sup>2+</sup>**

Glicerol +ATP → Glicerol-3fosfat +ADP

#### **GPO**

Glicerol-3-fosfat +O<sub>2</sub> → Dihidroksiaceton-fosfat + H<sub>2</sub>O<sub>2</sub>

#### **POD**

2H<sub>2</sub>O<sub>2</sub> +4AAP +4-Klorfenol → Substancë me ngjyrë të kuqe +H<sub>2</sub>O

## **Përbërja e reagentëve të punës.**

Kiti i Trigliceridit përmban dy reagent:

R1-Bufer, Mg<sup>2+</sup>, Klorfenol, aminoantipirinë, ATP

R2:Lipazë, Glicerol kinazë, Peroksidazë, Askobat oksidazë, glycerol-3 fosfat oksidazë.

## **Qëndrueshmëria e reagentëve**

Reagentët e pahapur janë të qëndrueshëm në temperaturën 2-8 gradë celcius deri në datën e skadimit që e ka në etiketën shoqëruese ;kur hapen janë të qëndrueshëm po në këtë temperaturë por për 30 ditë.

## **Materiali biologjik**

Serum ose plazëm e heparinizuar ose me EDTA. Rekomandohet që bërnda dy orëve pas centrifugimit të ndahet serumi nga elementet e tjerë të gjakut. Trigliceridi është i qëndrueshëm në serum për 5-7 ditë në temperaturën 2-8 gradë.

Për këtë kit lineariteti i kurbës është deri në 10-1000mg/dl (1-11.3 mmol/l)

## **Normat**

0-150 mg/dl (<1.70 mmol/l ) vlerë normale

150-199 mg/dl (1.7-2.2 mmol/l) risk i mesëm

200-499 mg/dl ( 2.2- 5.6 mmol/l) risk i lartë

## **Matja e LDL kolesterolit në serum.**

LDL janë lipoproteinat me përqëndrim më të madh në plazëm.Ato janë transportuese kryesisht të kolesterolit (mesatarisht 80%), në trajtë të esterifikuar.Prandaj për matjen e kësaj lipoproteine duhet fillimisht që të ndahet nga lipoproteinat e tjera të pranishme në materialin biologjik.

Si material biologjik përdorim serum, ose plazëm të heparinizuar.

## **Principi i reaksionit.**

Një agjent mbrojtës i LDL i cili është i pranishëm në reagentin e punës R1, mbron LDL nga reaksionet enzimatike.Të gjitha lipoproteinat e tjera (HDL, VLDL, CM) shkatërrohen nga veprimi katalitik i enzimave si:kolesterol esteraza (CE), kolesterol oksidaza (CHOD). Peroksidi i hidrogjenit (H<sub>2</sub>O<sub>2</sub>) i prodhuar nga veprimi i këtyre enzimave, dekompozohet nga katalazat e pranishme në reagentin R1.Kur shtojmë reagentin R2, reagent mbrojtës R1 clirohet nga LDL dhe katalazat bëhen inactive nga azothidrati i natriumit.LDL mundet tashmë që të përcaktohen nga ana sasisore nëpërmes sistemit CHOD/PAP.

## **Faza R2 e principit të reaksionit.**

### **CE, CHOD**

LDL kolesterol +H<sub>2</sub>O +O<sub>2</sub> → Kolest-4-en-3-on +acide yndyrore +H<sub>2</sub>O<sub>2</sub>

Clirim i reagentit R1

## POD

H<sub>2</sub>O<sub>2</sub>+4AA +HDAOS

→

ngjyrim blu +3H<sub>2</sub>O

### **Përberja e reagentëve të punës.**

Kolesterol esteraza, kolesterol oksidaza, peroksidaza, azodhidrati I Na, soluzion tampon Good (Ph 6.8), 4 aminoantipirina, katalaza, HDAOS, detergent.

### **Qëndrueshmëria e reagentëve**

Reagentët e pahapur janë të qëndrueshëm në temperaturën 2-8 gradë celcius deri në datën e skadimit që e ka në etiketën shoqëruese ;kur hapen janë të qëndrueshëm po në këtë temperaturë por për 30 ditë.

### **Materiali biologjik**

Serum ose plazëm e heparinizuar ose me EDTA. Rekomandohet që bërnda dy orëve pas centrifugimit të ndahet serumi nga elementet e tjerë të gjakut. LDL janë të qëndrueshëm në serum për 5-7 ditë në temperaturën 2-8 gradë, dhe një ditë në temperaturë 15-25 gradë.

### **Lineariteti**

Për këtë kit lineariteti i kurbës është deri në 10-400mg/dl (0.26-10.3 mmol/l)

### **Normat**

0-100 mg/dl (<2.6 mmol/l) –vlerë normale

100-129mg/dl (2.6-3.3 mmol/l) , pothuajse normale

130-159 mg/dl ( 3.4- 4.1mmol/l) vlerë limite

160-189 mg/dl (4.1-4,9 mmol/l) vlerë e lartë.

### **Matja e HDL-kolesterolit.**

HDL-kolesteroli i njohur ndryshe dhe si “kolesteroli i mirë”, ka si funksion transoprtin ekundërt të kolesterolit, dmth, nga indet drejt heparit, ku dhe “digjet”.Pra sa më e lartë të jetë si vlerë kjo lipoproteinë aq më i mbrojtur është organizmi jonë nga dukurite aterosklerotike.

### **Principi i testit**

Antikorpët antilipoproteinë humane të pranishme me reagentin R1 lidhen me të gjitha lipoproteinat e pranishme në materialin biologjik, më përjashtim të HDL-Kolesterolit.Kompleksi antigen-antikorp I formuar në këtë mënyrë bllokoi zhvillimin e reaksioneve enzimatiske, pasi shtohet reagenti R2, duke lënë në këtë mënyrë që HDL-kolesteroli ti nënshtrohet një kaskade reaksionesh, me rezultat formimin e nje bashkedyazimi të ngjyrosur blu, intensiteti I së cilës është në përpjestim të drejtë me përqëndrimin e HDL.

### **Principi reaksionit**

## Antikorpjet anti $\beta$ -lipoproteine humane

LDL, VLDL, CM → kompleksin antigen/antikorp  
CE, CHOD

HDL- kolesterol +H<sub>2</sub>O+O<sub>2</sub> → Kolest-4-en-3-on+ acide yndyrore +H<sub>2</sub>O<sub>2</sub>  
POD

H<sub>2</sub>O<sub>2</sub>+4-AA+F-DAOS → bashkëdysim ngj.blu +2H<sub>2</sub>O

### **Përberja e reagentëve të punës.**

Kolesterol esteraza, kolesterol oksidaza, peroksidaza, Antikorpjet anti  $\beta$ -lipoproteine humane  
soluzion tampon Good (Ph 6.8), 4 aminoantipirina, katalaza, F-DAOS, detergent.

### **Qëndrueshmëria e reagentëve**

Reagentët e pahapur janë të qëndrueshëm në temperaturën 2-8 gradë celcius deri në datën e skadimit që e ka në etiketën shoqëruese ;kur hapen janë të qëndrueshëm po në këtë temperaturë por për 30 ditë.

### **Materiali biologjik**

Serum ose plazëm e heparinizuar. Rekomandohet që bërnda dy orëve pas centrifugimit të ndahet serumi nga elementet e tjerë të gjakut. HDL janë të qëndrueshëm në serum për 5-7 ditë në temperaturën 2-8 gradë, dhe dy ditë në temperaturë 15-25 gradë.

### **Lineariteti**

Për këtë kit lineariteti i kurbës është deri në 2-180mg/dl (0.06-4.65 mmol/l)

### **Normat**

< 40 mg/dl (<1.03 mmol/l) –risk për patologji kardiovaskulare

>60 mg/dl (>1.55 mmol/l) , vlere normale

## **Matja e Glukoze në serum me metoden enzimatiko kolorimetrike**

### **Principi i metodes**

Enzima Hekzokinazë (HK) katalizon fosforilimin e Glukozës në prani të Adenozinë trefosfat(ATP) dhe joneve Magnez, duke na formuar Glukozës 6 –fosfat. Glukozë 6-fosfat dehidrogjenaza është enzima që katalizon oksidimin e Glukozë 6-fosfatit në glukonat 6-fosfat.Matja e absorbancës në gjatësinë e valës 340 nm është në përpjestim të drejtë me përqëndrimin e glukozës në gjak.

### **Principi i reaksionit.**

**HK, Mg<sup>2+</sup>**

Glukozë +ATP → Glukozë 6-Fosfat +ADP

Glukozë 6-Fosfat + NAD<sup>+</sup> → Glukoze 6-Fosfat +NADH + H<sup>+</sup>

### **Përberja e reagentëve të punës.**

Solucion Tampon PPES( Ph 7.6); ATP, NAD<sup>+</sup>, Mg<sup>2+</sup>, Hekzokinazë, G6P-DH si dhe konservues.

### **Qëndrueshmëria e reagentëve**

Reagentët e pahapur janë të qëndrueshëm në temperaturën 2-8 gradë celcius deri në datën e skadimit që e ka në etiketën shoqëruese ;kur hapen janë të qëndrueshëm po në këtë temperaturë por për 30 ditë.

### **Materiali biologjik**

Serum ose plazëm e heparinizuar. Glukoza është e qëndrueshme në serum për 5-7 ditë në temperaturën 2-8 gradë, dhe dy ditë në temperaturë 15-25 gradë.

### **Lineariteti**

Për këtë kit lineariteti i kurbës është deri në 1-800mg/dl (0-45 mmol/l)

### **Normat**

Për të rritur 76-106 mg/dl ( 4.1-5.9 mmol/l)

Për fëmijët 60-100 mg/dl (3.3.-5.6 mmol/l)



## Kapitulli III

### 3. Rezultatet

#### 3.1 Vleresimi i aktivitetit të alpha -5-reductazes në ovarin polikistik në kuadrin e një gjëndje hiperandrogjenizmi

Në studim u morën rreth 100 paciente të diagnostikuara me PCOS të grup moshave nga 16-40 vjeç .Ky vlerësimin u bë duke përbushur kriteret e Rotterdam i cili përfshin:

- 1) oligo- ose anovulacion,
- 2) Shënja klinike dhe/ose biokimike të hiperandrogjenizmit
- 3) Ovar polikistik (më shumë se 12 kiste)

Në bazë të të dhënave të mbledhura shpërndarja e ovarit polikistik sipas grupmoshave paraqitet ne grafikun me poshte ku përqindjen më të madhe e zë mosha 20-30 vjeç:


Sipas grupmoshës popullata u nda në 4 grupe: 13- 20 vjeç, 21-30 vjeç,31- 35 vjeç, 36-40 vjeç.

**Tabela Nr 1**

Grup mosha	%
13- 20 vjeç	33
21-30 vjeç	41
31-35 vjeç	15
36-40 vjeç	11
Nr	100

Në tabelën e mësipërme janë përshkruar ndarja në % sipas grupmoshave ku grupmosha 13-20 vjeç zë 33%, grupmosha 21-30 vjeç zë 41 %, grupmosha 31-35 vjeç zë 15 % dhe grupmosha 36-40 vjeç zë 11% të rasteve. Këto të dhëna janë hprehur dhe në grafikun e mëposhtëm(grafiku nr 1)

## Shpërndarja sipas moshës



**Grafiku nr 1.** Shpërndarja e PCOS sipas moshës : 13-20 vjec 33 %, 21-30 vjec 41%, 31-35 vjec 15 %, 35-40 vjec 11%.


Në varësi të të dhënave të mbledhura u vu re një shpërndarje manifestimeve klinike tek pacientet me PCOS e paraqitur në tabelën nr 2

**Tabela Nr 2**

Manifestimet klinike	Raste	Përqindja %
<b>Manifestime të hiperandrogjenizmit</b>		
Hirsutism	72	72
<b>Manifestime të disfunktionit ovarial</b>		
Oligomenorrhea	56	56
Amenorrhe	11	11
Cikel normal	13	13
Ovar polikistik ne Echo	100	100
Obezitet	54	54

Ne tabelën e mësipërme tregohet shpërndarja e shenjave klinike të pacienteve në studim në bazë të vlerësimit të kritereve të Rotterdam .

Shpërndarja në grafikun e mëposhtëm.(grafiku nr 2)



Grafiku nr 2. Shpërndarja e shënjave klinike të pacienteve në studim në bazë të vlerësimit të kritereve të Rotterdam


Duke bërë krahasime mes të dhënave të grupit të kontrollit dhe të dhënave të pacienteve me PCOS për vlerat e TT, DHT dhe raportit TT/DHT vihen re këto të dhëna (tabela nr 3)

**Tabela nr 3**

		N	Mean	Std. Deviation	p value
<b>TEST</b>	Kontrolli	30	0,485	0,172	< 0.001
	PCOS	100	0,909	0,413	
<b>DHT</b>	Kontrolli	30	18,933	6,968	< 0.001
	PCOS	100	37,367	14,160	
<b>TT/DHT</b>	Kontrolli	30	2,787	1,223	0.664
	PCOS	100	3,054	3,289	

Në tabelën e mësipërme shprehet korelacioni mes vlerave të TT, DHT dhe raportit TT/DHT. Vihet re se kemi një korelacion pozitiv për TT dhe DHT (perkatësisht  $p < 0.001$ ) ndërsa përsa i përket raportit nuk është sinjifikativ ( $p = 0.664$ )

Këto të dhëna paraqiten dhe në grafikun e mëposhtëm (grafiku nr 3)



**Grafiku nr 3:** Korelacioni mes korelacioni mes vlerave të TT, DHT dhe raportit TT/DHT. Vihet re se kemi një korelacion pozitiv për TT dhe DHT (perkatësisht  $p < 0.001$ ) ndërsa përsa i përket raportit nuk është sinjifikativ ( $p = 0.664$ )


Duke bërë krahasime mes të dhënave të grupit të kontrollit dhe të dhënave të pacientëve me PCOS për vlerat e FSH, LH dhe raportit LH/FSH vihen re këto të dhëna (tabela nr 4)

**Tabela nr 4**

		N	Mean	Std. Deviation	P value
<b>FSH</b>	Kontrolli	30	4,82	2,15	0.338
	PCOS	100	5,25	2,16	
<b>LH</b>	Kontrolli	30	5,63	3,34	< 0.001
	PCOS	100	12,74	7,79	
<b>E2</b>	Kontrolli	30	56,93	19,67	0.83
	PCOS	100	58,22	49,08	
<b>LH/FSH</b>	Kontrolli	30	1,16	0,47	< 0.001
	PCOS	100	2,66	2,15	

